

MUSTAFA NANO

SELAM  ALEIKUM

BABA!
Bukinist

pasioni për librat

Nga Rubairat e Omer Khajamit:



A hundred Ka'bas equal not one heart,
Seek not the Ka'ba, rather seek a heart!

Përkthyer nga E.H. Whinfield

Bukinist

pasioni për librat

Një qind Qabera s'vlejnë sa një zemër [vajze];
Zemra kërkoni, haxhínj, jo Gur Qabeje!

Përkthyer nga Fan S. Noli

E PREMTJA E ADLI SHEL BËS



Bukinist
pasioni për librat

Ende pa e mbyllur telefonin, zuri të pyeste veten nëse ishte Bora që i tha se i kishte vdekur babai, apo ishte e qara e saj me dënese që e bëri ta mendojë atë gjë. “Si, kaq papritur?”, ia bëri Adli me vete, por një çast më vonë mendoi shí të kundërtën, mendoi se veç e papritur nuk ishte. Kishte kaluar më shumë se një javë qysh prej momentit që i kishin bërë një ndërhyrje kirurgjikale në kokë, dhe nuk ishin vënë re përmirësime, ndonëse atij vetë, edhe pse nuk ngrihej dot nga shtrati, i bëhej herë pas here se ishte më mirë, se nuk kishte marrje mendsh, as dhembje, e pas kësaj lehtësohej edhe ca më shumë kur bindej se të tjerët që qëllonin aty rrotull kishin të njëjten ndjesi, gjë që dukej nga pamja e tyre e ngazëllyer e nga ndonjë frazë e llojit “po, po, sot dukesh më mirë”, ose “pasi edhe për mirë do bëhesh”. Adli kishte shkuar ta vizitonte atë ditë, tok me Fan Poçemin që e kishte takuar rastësisht te porta e xhamisë së Efendinjëve, që ishte ngjitur me spitalin. Ishte Fani që i kishte shprehur dëshirën për ta shoqëruar. “Sa mirë që u takuam. Kisha kohë që mendoja t’i bëja një vizitë Bekimit në spital. Po vij me ty”, i kishte thënë.

E kishin gjetur në gjumë. Nëna i rrinte te kryet, e nuk bënte asnjë përpjekje ta fshihte se e kishte lëshuar zemra. Pati një çast që Adlit i erdhi më shumë keq për të sesa për babanë që dergjej në shtrat i sëmurë rëndë, dhe u bë gati t’ia thoshte këtë gjë, por i rigëlltiti fjalët pa i lënë të kalojnë pragun e buzëve. Dhe si për t’u siguruar se e kishte bërë vërtet këtë gjë, instinktivisht u kapërdi,

madje me një lëvizje fare të ngadaltë, si në një moviolë. “Hë, idiot!”, i tha vetes, pa e kuptuar mirë, megjithatë, nëse ky qortim kishte lidhje me çfarë i erdhi në kokë për t’ia thënë nënës, apo me faktin që e vuri fikthin të bëjë një lëvizje të kotë vajtje-ardhje.

Nuk kishin ndenjur gjatë. Në fund, para se të dilnin, Adli i kishte vënë dorën në kokën e shogët, që veç në shtëpi i kishte qëlluar t’ia shihte zbuluar. Babai mbante prej vitesh një kësulë, me një pipth në mes, në pjesën e jashtme, që e identifikonte si mysliman kudo që ndodhej. E kishte prekur në pjesën e pambuluar nga garzat e bardha, e kishte ledhatuar një copë herë, dhe i kishte ardhur mirë që ai nuk kishte vonuar t’i përgjigjej këtij gjesti, s’ka gjë se pa hapur sytë, thjesht me një të mbledhur të buzëve. Me të mbyllur derën e dhomës, Fani i kishte thënë se mënyra si ia kishin lidhur garzat, d.m.th njëherë horizontalisht rreth kokës, në pjesën e ballit, duke lënë të zbuluar çakënen, e pastaj vertikalisht, duke ia kaluar poshtë mjekrës, i sillnin në mendje disa malësorë të veriut, katolikë e myslimanë, të cilët e kishin praktikuar këtë gjë për shekuj me radhë e deri në fillim të shekullit XX, ndoshta tek-tuk edhe sot e kësaj dite.

Adli donte të kujtonte se ç’ditë ishte, dhe i erdhi e lehtë: E premte. Nuk kishte pasur asnjë libër të Dy Ortakëve, ku sapo kishte falur namazin, të vetmin namaz që falte herë pas here, kur mundte, ose - siç i thoshte babai - kur i shkrepej, dhe i shkoi mendja ta rimerrte në telefon Borën, së cilës një a dy minuta më parë nuk kishte mundur t’i thoshte asnjë fjalë. Kishte qenë një dialog mes ngashërimit të saj e topitjes së tij. Kishin fjetur bashkë një natë më parë. Nuk është se kjo gjë ndodhte shpesh, ngaqë Borës i duhej të kujdesej për nënën e vet, së cilës një gjendje e hershme limontie i ishte shndërruar në depresion pas vdekjes së të shoqit një vit më parë, por gjatë ditëve të fundit nënën ia kishte besuar motrës që ishte në vit të dytë të shkollës së mesme, dhe vetë, me të mbaruar mësimin në Fakultetin Filologjik të Ch-së, e mbante

frymën në shtëpinë e Adlit. “Kam parë në ëndërr sikur kisha veshur një hixhab, dhe me të kisha shkuar në shkollë. Të gjithë, studentë e pedagogë, nuk m’i ndanin sytë a thua se isha lakuriq”, i kishte thënë ajo në mëngjes, ende pa u ngritur nga shtrati. “Ëndërr e çuditshme, apo jo?” “Ka ëndrra shumë më të çuditshme”, ia kishte kthyer ai përgjumazi.

Në ekranin e telefonit pa njoftimin për tri thirrje që kishin mbetur pa përgjigje. Ishin të tria të Borës, që i kishin ardhur gjatë kohës që ai kishte qenë në xhami. “Kjo është shenjë e sigurt se babai ka vdekur”, ia bëri ai duke e larguar krejt ndonjë dyshim që i kishte mbetur nga biseda e belbët me Borën. “Ndryshe pse do më dërgonte tri thirrje, duke ditur se unë isha duke falur namazin?” E rimori, megjithatë. Ajo e hapi telefonin qysh në thirrjen e parë.

“Kur ndodhi?”

“Para një gjysmë ore”, mundi të thoshte ajo mes gulçeve të mbetura.

“Unë po iki në spital”.

“Jo, nuk ka nevojë, Adli. Hana nuk është vetëm. Atje kanë mbërritur të gjithë”.

Adli zuri të mendonte me vete se kush dreqin ishin këta “të gjithë” që kishin shkuar në spital për librin shoqëri nënës së tij, dhe u mat ta pyeste Borën, por nuk iu desh shumë për të ndërruar mendim, ngaqë kjo iu duk gjëja më e parëndësishme në atë rrethanë. Mendja nuk iu shqit menjëherë nga këta “të gjithë”, sidoqoftë. Si paskan mbërritur sa hap e mbyll sytë, a thua se kanë qenë duke pritur prapa derës vdekjen e tij? Bora zuri të fliste, si për ta larguar nga këto mendime.

“Unë po marr autobusin e po shkoj në shtëpinë tënde. Po të pres atje”.

Adli lëshoi nëpër dhëmbë një si murmurimë, i sigurt se ajo do të merrej për “ok” nga Bora. Dhe mbylli telefonin.

Për një moment besoi se ngjarja do ta përpinte, si një shtjellë, por

nuk ishte kjo që po ndodhte. Përkundrazi, nuk po kuptonte pse, por në mendje kishte vetëm Borën. Kishte ende në vesh tingullin e zërit të saj: “Unë po marr autobusin...” E përfytyroi në autobus, me një fund të gjatë deri te takat e këpucëve e me një hixhab në ngjyrë të çelur të hedhur mbi krye, me kindat e poshtëm të lidhur rreth qafës, e ngucur mes udhëtarëve të shumtë, të cilët e lëpinin me shikime, e preknin rastësisht apo qëllimisht me bërryl, me gjunjë, i mbështeteshin në gjoks apo i ngjisheshin nga prapa duke pasur si alibí frenimet e buta që autobusi bënte në semaforë, në stacione, ose në mes të trafikut. “Hëm, është kjo dita për të menduar gjëra të tilla?” Por nuk është se gjeti ndonjë gjë të pazakontë në këtë mes. “Nuk ka gjo ma t’hallakatme se menia e robit”, i ktheu një përgjigje vetes, pa e ditur pse, në dialektin e Ch-së, që ai e përdorte shumë rrallë, në momente të shkujdesura a gazmore.

“Është bërë gjysmë ore që ka vdekur”, ia bëri, si të kishte gjetur mënyrën për t’iu përvjedhur xanxave të *menies* së vet, dhe aty për aty u kujtua se gjatë atij namazi, me siguri në kohën që i ati po jepte shpirt në spital, imam Abdurrahmani, që të shumtët e thërrisnin imam Patriku, për shkak të emrit, që i kishin vënë prindërit qysh në lindje, kishte përmendur në hutbenë e tij disa ajete që kishin të bënin me natyrën efiemere të jetës mbi tokë. Nuk i shqitej nga mendja zëri i mpakur i imamit, që kishte ca kohë që ishte i sëmurë. “Vuan nga një sëmundje e keqe”, kishte dëgjuar të thuhej në xhami. Në fakt, shenjat e sëmundjes i lexoheshin në fytyrën që i ishte bërë verdhacake. Adlit i dukej se edhe qimet e mjekrës i ishin zverdhur. Po mendonte se, sikur të mos ishte sëmundja e imamit, tanimë do ishte duke torturuar veten për t’i gjetur një kuptim përkimit në kohë mes vdekjes së të atit e këtyre ajeteve të recituara në një xhamí. Zëri i imamit, edhe pse i mekur, zuri t’i rikumbonte në vesh duke mbartur pohime të gjymtuara kuranike, të cilat ai, në përpjekje për t’mos i lënë të pambyllura, i bënte tok e i lidhte, duke pasur kujdes të mos i largohej mesazhit burimor: “Jeta e kësaj

bote nuk është gjë tjetër veçse... argëtim, lojë, ... biseda bjerradite, ngrefosje, mburravecëria, gërricje lodërtare, garë e rendje drejt begatisë materiale e kënaqësive boshe, e të mjerë janë ata që nuk arrijnë të dallojnë se jeta e botës tjetër është jeta e vërtetë”.

Ishte ende brenda xhamisë. Zuri të kërkonte me sy këpucët me të njëjtin panik instiktiv që kishte pasur edhe ditën e parë që kishte hyrë në një xhami, se mos këpucët nuk do t'i gjente, s'ka gjë se kurrë nuk kishte ndodhur te Dy Ortakët që dikush të mos gjente këpucët e veta, e kurrë nuk kishte dëgjuar që kjo të kishte ndodhur në ndonjë xhami tjetër. I gjeti, tok me dy tekste shkollore në italisht mbi edukimin civil që ia kishte kërkuar dikush t'ia përkthente në këmbim të një pagese të mirë. I kërkonin vazhdimisht që të bënte përkthime, ngaqë ai, përveç italishtes, njohte edhe anglishten e gjermanishten, ndonëse këto dy të fundit jo aq mirë sa të parën. Pas gjimnazit, ndërsa vërsnikët e tij, përfshirë edhe dy miqtë e tij të ngushtë, Nesti Papa e Ben Hoda, shkuan nëpër shkolla të larta, ai iu fut studimit të gjuhës angleze. I dukej se nuk kishte ndonjë aftësi a prirje, që mund ta zhvillonte nëpërmjet studimeve në universitet. I vetmi pasion i tij ishin gjuhët e huaja. Dhe feja. Për gati tre vjet me radhë, ai nuk dilte nga shtëpia. Ishte i përpirë nga besimi islam e nga gjuhët e huaja. Patej e studionte. “Është e vetmja gjë që di të bëj”, i kishte thënë ai të vëllait, Gurit, kur ky i fundit këmbëngulte se studimet universitare do t'i jepnin shumë më tepër sesa një diplomë.

Kishte pasur frikë se, me të filluar punë, do t'i bjerrej pasioni për gjuhët e huaja, por ndodhi e kundërta. Kthehej nga puna, dhe harrohej mes librave, fjalorëve, kasetave, filmave, e web-it. E kështu zuri të merrej edhe me përkthime, të cilat, përveç të tjerash, e bënë të nxirrte edhe një rrogë të dytë. Nami i kishte marrë dhenë, madje në Ch ishte krijuar edhe një legjendë, që thoshte se, përveç këtyre të triave, ai njohte edhe gjuhët ballkanike, lëre pastaj që arabishten e qante fare, ndryshe ç'kuptim do kishte që ishte

mysliman. “Thonë se i biri i Bekim Shelbës është duke mësuar edhe gjuhën e vjetër të hebrenjve, atë me të cilën ka folur Jezu Krishti, aramishten, aramakishten, nuk e di si dreqin quhet saktësisht”, kishte dëgjuar një herë Bora që dikush t’i thoshte dikujt në autobus. Dhe mes të qeshurave që mezi i kishte kontrolluar, kishte marrë në telefon Adlin, dhe me zë të ulët e kishte pyetur: “Po ti ditke edhe aramaikishten, dhe mua s’më ke thënë gjë?” Pastaj, i kishte kallëzuar atë që kishte dëgjuar.

Adli mori këpucët dhe, para se t’i mbathte, i vajtën sytë te vula e fabrikës të bërë te pjesa e brendshme e këpucës, te shtresa ku zinte vend shputa e këmbës: *Made in Albania*. Ishin të prodhuara në Ch, në fakt, në një fabrikë të hapur nga një industrialist italian. I mbathi pa ndonjë ngut, dhe nuk po kuptonte nëse me këtë po gjente një mënyrë për të pritur Fanin të dilte nga xhamia, që t’i thoshte se babai i kishte vdekur, apo ishte mpirë aq shumë sa vdekja e babait, paradoksalisht, e bënte të mendonte se nuk kishte për çfarë të ngutej. “Jam vërtet i mpirë?”, pyeti veten një çast më vonë, ngaqë zuri të mos e besonte këtë pandehmë të tijën. “Nuk më duket se jam i mpirë, madje, është e kundërta, jam krejt i çmpirë”.

E kishte menduar shpesh vdekjen e të atit, ashtu si edhe vdekjen e të dashurve të tjerë, gjithashtu, e aty për aty u vu të bindte veten se, për shkak të përgatitjeve të gjata e provave të shumta që lidheshin me një shfaqje që nuk kishte si ta dinte se kur do të jepej, qenkësh mësuar me dhembjen, apo e paskësh namatisur atë a thua se ishte një lëndë e dreqosur brenda shpirtit të tij, që edhe mund të hiqej, e jo një ndjesi nga më normalet, në mos më normalja, e njeriut. Pastaj, i ishte mbushur mendja qysh herët, e nuk kishte ndryshuar mendim më pas, se të shumtët e njerëzve, ndoshta të gjithë, përfshirë dhe ai vetë, janë të merakosur jo aq për të dashurin që ka vdekur, sesa për të tërhequr vëmendjen e gjindjes me maskën e tyre të dhembjes. *L'uomo è di natura misero e meschino*. E kishte lexuar diku këtë gjë? Apo i erdhi në mendje

aty, në atë çast? Bah!

Nuk e kishte marrë vesh asnjëherë pse i pëlqente të lozte para kohe me vdekjen e njerëzve të tij. Fillimisht s'e kishte për gjë të besonte se në këtë mënyrë do t'ua ndillte atë, ashtu siç bënte me të vetët Klara në "Shtëpinë e Shpirtrave" të Isabel Allendes, dhe nuk është se befasohej që nuk i dukej vetja i lig, që nuk ndihej në faj, që nuk trazohej kushedi se çfarë prej idesë se ndonjëri, apo disa, apo - kushedi? - të gjithë mund të vdisnin, njëherësh apo njëri pas tjetrit, por koha kalonte, asgjë nuk ndodhte, çdo gjë rridhte si më parë, derisa erdhi një moment kur, i pafuqishëm siç ishte për të mos rendur pas shpjegimeve skaramantike, zuri të besonte të kundërtën, d.m.th që e gjithë kjo jo vetëm që nuk ua ndillte vdekjen të dashurve të vet, por shërbente si një yshtje për ta, dhe kështu përfytyrimi këmbëngulës i vdekjes së të dashurve qenkësh e thënë të shndërrohej në eliksirin e jetës së tyre. Nuk është se hiqte shumë për t'i mbushur mendjen vetes se të kërkoje një shenjë të përbashkët a një detaj lidhës në njëpasnjshmërinë e gjërave që na ndodhin në këtë jetë, e për t'i parë këto shenja/detaje, sipas rastit, si ogurbardha apo ndjellakeqe, ishte një gjë marrokësh, por kjo ngasje nuk i shqitej që nuk i shqitej, për më tepër ishte e çuditshme që nuk i ishte shqitur as me pas kur, për shkak të besimit islam që përqafoi, mund t'i merrej kollaj-kollaj për një blasfemi. I pritej hovi ndonjëherë prej pohimit të prerë kuranik se, mbi tokë, asnjë gjethe peme nuk bie pa miratimin e dijeninë e të Gjithëdijshtit dhe e të Gjithëfuqishmit, por nuk vononte të vinte hera kur ai u dorëzohej fiksimeve besëtyte, që te njerëzit janë aq të forta sa, kështu mendonte hera-herës, u mbijetojnë edhe pasioneve fetare më të shfrenuara. Në raste të tilla gati e bindte veten, mes një trazimi që nuk mund ta shmangte, se është në dorën tonë të heqim dorë nga besimi në Zot, por nuk është në dorën tonë të heqim dorë nga besëtytnitë.

Babait nuk i pëlqenin këto mendime të ngulëta skaramantike

të tijat. Mbante mend se në një moment, para shumë vitesh, teksa Adli ishte duke dëgjuar në mënyrë miratuese t'ëmën që po thoshte diçka për dikë që e kishin marrë m'sysh, i ati ia kishte bërë: "Mos ia vër veshin Hanës! Për një mysliman si ty nuk janë besëtytnitë, a ndeshtrashja të tjera të njeriut në tokë, ato që përcaktojnë fatkeqësitë, por është Zoti". Nuk është se flisnin shumë lidhur me këtë argument, por sa herë që e bënin, nuk e shmangnin dot ndonjë gër-vër. I ati hahej veç me Adlin që ishte mysliman. Ishte mysliman në mënyrën e tij, kuptohet, gjë që babanë e bezdiste. "Një mysliman me hënëz, siç je ti, në të vërtetë nuk është mysliman", i thoshte ai. Por ishte po ai që ngushëlluhej, në ndonjë rast edhe ngazëllehej, kur Adli në prani të tij e të njerëzve të tjerë e thoshte me gojën plot që ishte mysliman. Nuk është se e shprehte këtë ngazëllim, por nuk ishte nevoja, pasi i lexohej në fytyrë. Besimi i përbashkët nuk është se ua lehtësonte komunikimin. Por ua bënte të mundur atë, sidoqoftë. Ndërsa vëllai i tij kishte një marrëdhënie tjetër me babanë, të heshtur, të ftohtë, të mundimshme, për të mos thënë të pamundur. Guri, që kishte vite që jetonte në Graz të Austrisë, fillimisht si student, e më pas si asistent pedagog e pedagog i lëndës së historisë së Mesjetës në universitetin ku ishte diplomuar, sa herë që kthehej në Ch, pasi çmallej me të gjithë, nuk i rrihej pa i hedhur spica babait, me synimin për ta tërhequr në një bisedë mbi fenë e mbi Islamin, por babai bënte çmos t'i bënte bisht, e shfaqte hapur që nuk donte të kapej me fjalë me të, nuk i zemërohej edhe kur ai e lëndonte me fraza të pakujdesshme, dhe kjo ishte një gjë që bënte përshtypje, ngaqë rëndom ai gjallërohej nga një bisedë e kësaj natyre me të tjerë, sidomos me të shoqen e të birin që i kishte në shtëpi. "E di Guri, të vetmin shpjegim të sjelljes së tij me ty, e kam gjetur tek Ungjijtë e Dhiatës së Re, te parabolat e profetit Isa", i kishte thënë në një rast Adli. "Ai sheh te ti delen a monedhën e humbur, që shpreson t'i rigjejë; ti je për të djali plëngprishës që ka vdekur e që ai mezi po pret të rivijë

në jetë”. Të vëllait nuk i ishte dukur pa gjë ky version, por kishte shtuar: “Nëse është njëmend kështu, e ka kot, pasi kurrë nuk ka për të më rigjetur”.

“Ia kanë thënë vallë Gurit që ka vdekur babai?”, pyeti veten. Nxori telefonin për ta marrë, mirëpo në momentin e fundit e kapi veten që po i binte numrit të agjencisë së pronave të paluajtshme, ku punonte prej disa vitesh, që ishte më e madhja e qytetit. Ishte larguar sa për të falur namazin e së premtes, dhe atje e prisnin që të kthehej. Iu përgjigj Maida, një vajzë myslimane që punonte me të në zyrë. Përpara se t’i dëgjonte zërin, ai e përfytyroi duke rendur drejt telefonit të zyrës, siç bënte gjithnjë, një dreq e dinte pse, sa herë binte zilja e tij. Fillimisht kishte dyshuar se ajo ishte në pritje të ndonjë telefonate të rëndësishme, s’ka gjë se ishte pak e pashpjegueshme që kjo telefonatë të vinte te numri i zyrës, e jo te celulari i saj. Më vonë, nuk e kishte vrarë më mendjen. “Duhet të jetë ndonjë rrebe e saj”, kishte menduar Adli, “siç janë mallkimet që, një e dy, i nxjerr nga goja”. Ajo i bënte mallkimet pa të keq, kuptohej, por kjo gjë Adlin e bezdiste po njësoj. Në Shqipëri, edhe në Ch, mallkimet janë huqe të grave të moshuara, dhe Maida ishte e vetmja vajzë e moshës së vet, për aq sa njihnte ai, që mallkonte si plakat e qëmoçme. “Vdeksh ti, sa i poshtër që je!”, i thoshte Adlit ndonjëherë kur ky i fundit hidhte ndonjë romuz apo lëshonte ndonjë batutë, që asaj i dukej “me të hedhur”. Mallkimet e saj nuk kishin të sosur. “Është dhe kreative, dreqi”, ia bënte Bert Sinja, shefi i të dyve, dhe ia numëronte nëmat që hidhte, ato që i kujtoheshin afërmendsh: “U shofsh, ngordhsh, të hëngërt qimja, të rënçin krahët etj, etj”. Ndonjëherë ajo i ngjyrote edhe në mënyrë myslimane: “Ardhsh xhenaze! Të zgjofshin shejtanët!” Adlit i ngjante sikur desensualizohej prej kësaj mënyre të folure. Ia kishte thënë dhe Borës. “Nëse ka një arsye që të mos bëhesh xheloze për të, është ky zakon plakash që ajo ka. Unë nuk do shkoja kurrë me të”.

“Maida, unë nuk do kthehem sot. As nesër. Më ka vdekur